

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6846
E shtunë, 11 mars 2023
çmimi 0.40 €

Qëndrim Gashi: Kosova duhet ta shfrytëzojë çastin, të hedhë një hap vendimtar




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LAJÇAKU E INFORMOI OPOZITËN PËR PRITJET E KOMUNITETIT NDËRKOMBËTAR LIDHUR ME PLANIN E BE-së



I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, i ka informuar të premtën liderët e opozitës për

pritjet e komunitetit ndërkombëtar lidhur me planin e BE-së. Pas takimeve me liderin e PDK-së, Memli Krasniqi, atë të

LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe të AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se këto takime kanë përbushur qëllimin

RAPORTI I UNDP-së: BIE KËNAQSHMËRIA NË PUNËN E QEVERISË DHE TË KRYEMINISTRIT

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka publikuar edicionin e 23-të të përmbledhjes Pulsi Publik nga i cili rezultoi se ka një rënie të kënaqshmërisë të qytetarëve për performancën e qeverisë, por edhe për atë të

legjislativit dhe gjyqësorit. Sipas këtij raporti, ka një rënie prej 7.7 pikë të përqindjes së kënaqshmërisë për performancën e kryeministrit për një periudhë gjashtëmuajore, ndërkohë edhe për performancën e qeverisë ka rënie prej 6.2 pikë të përqindjes

INSTITUCIONI	Q1 2019	Q2 2019	Q3 2019	Q4 2019	Q1 2020	Q2 2020	Q3 2020	Q4 2020	Q1 2021	Q2 2021	Q3 2021	Q4 2021	Q1 2022	Q2 2022	Q3 2022	Q4 2022	Tend.	
KËNAQSHMËRIA ME KRYEMINISTRIN	17.70%	16.40%	16.70%	21.30%	18.10%	17.80%	17.20%	17.20%	17.20%	17.20%	17.20%	17.20%	17.20%	17.20%	17.20%	17.20%	17.20%	-
KËNAQSHMËRIA ME QEVERISË	16.50%	16.50%	16.40%	23.00%	18.50%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	-
KËNAQSHMËRIA ME LEGJISLATIVIN	23.60%	25.00%	22.40%	18.70%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	18.20%	-
KËNAQSHMËRIA ME GJYQËSORIN	18.70%	19.30%	24.80%	23.00%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	18.90%	-

AKTUALE



BIDENI PUBLIKON PLANIN PËR BUXHETIN E VITIT 2024

RRITET MBITËRHEQJA E PARAVE NGA BANKAT, NË VITIN 2022 QYTETARËT 415 MILIONË EURO 'OVERDRAFT'

UNICEF-i DHE "DEVOLLI CORPORATION" BASHKOJNË FORCAT PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË

EKONOMI



LEKAJ: AAK-ja, KATEGORIKE KUNDËR SHITJES TË ENERJISË ELEKTRIKE

ME MBËSHETJEN E GJERMANISË, KOSOVA NIS NJË PROJEKT KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

SPORT



SOT DY NDESHJE NË SUPERLIGË, DERBI ZHVILLOHET TË HËNËN

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni publikon planin për buxhetin e vitit 2024

WASHINGTON, 10 MARS - Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, ka publikuar një plan shpenzimesh qeveritare prej 6.8 trilionë dollarësh për vitin 2024, duke bërë thirrje për dhjetëra iniciativa të reja dhe taksa më të larta për korporatat dhe individët e pasur. Por republikanët thanë menjëherë se buxheti i propozuar nga presidenti Biden nuk ka shans të miratohet nga Kongresi. Presidenti demokrat Joe Biden, i cili është në mandatin e tij të parë në Shtëpinë e Bardhë dhe ka thënë se do të kandidojë për një mandat të dytë vitin e ardhshëm, bëri thirrje për më shumë fonde për konkurrencën ekonomike dhe ushtarake me Kinën, shpenzime më të mëdha për kujdesin shëndetësor për amerikanët, nisma të reja arsimore dhe për rritjen e personelit të Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit. "Kina është konkurrentja e

vetme e Shteteve të Bashkuara me synimin dhe fuqinë gjithnjë e më të madhe ekonomike, diplomatike, ushtarake dhe teknologjike për ta ndryshuar rendin botëror", tha Shtëpia e Bardhë në një përmbledhje të buxhetit. Publikimi i planit të buxhetit vjen në një kohë kur Shtetet e Bashkuara së shpejti pritet të përballesh me një debat partiak mbi rritjen e tavanit të borxhit prej 31.4 trilionë dollarësh të vendit. Nëse presidenti Biden dhe Kongresi nuk bien dakord për rritjen e tavanit të borxhit në muajt e ardhshëm, Shtetet e Bashkuara mund të mos jenë në gjendje t'i përmbushin detyrimet e tyre financiare për herë të parë në histori, një katastrofë financiare që mund të ndikojë në tregjet botërore dhe mund ta rrisë nivelin e papunësisë në vend. Kundërshtarët e presidentit Biden në Dhoma e

Përfaqësuesve, të kontrolluar nga republikanët, kanë bërë thirrje për shkurtime të mëdha të shpenzimeve qeveritare, jo rritje të tyre në 12 muajt ardhshëm. Presidenti Biden ka propozuar një rritje të shpenzimeve qeveritare për 12 muajt e ardhshëm, duke filluar nga 1 tetori, për ta frenuar rritjen e deficitit vjetor që ka arritur në më shumë se 1 trilionë dollarë. Republikanët thonë se shpenzimet qeveritare janë jashtë kontrollit dhe disa programe qeveritare duhet të shkurtohen ose eliminohen. Ndërkohë, presidenti Biden po bën thirrje për rritjen e taksave për të pasurit, ata që fitojnë më shumë se 400 mijë dollarë në vit, dhe korporatat për t'i financuar programet e tij të reja ose për t'i zgjeruar ato. Publikimi i përparësive buxhetore të Bidenit i hap rrugë një debati disamujor mbi shpenzimet qeveritare.



Tetë persona të vrarë në Hamburg



HAMBURG, 10 MARS - Tetë persona janë vrarë dhe disa të tjerë janë plagosur nga të shtënat me armë zjarri brenda një objekti të përdorur si kishë nga Dëshmitarët e Jehovahit në qytetin verior gjerman të Hamburgut të enjten në mbrëmje, ka konfirmuar Policia e Gjermanisë. Policia e Hamburgut tha gjatë natës se beson se ishte vetëm një sulmues dhe se besohet se ai ishte në mesin e të vdekurve. Ata bënë të ditur se pasi oficerët arritën dhe gjetën njerëz me plagë të dukshme me armë zjarri në katin e parë, ata dëgjuan një të shtënë në katin e sipërm dhe

gjetën një person të plagosur rëndë aty, për të cilin dyshohet se mund të ketë qenë sulmuesi. "Hetimi për motivin e krimit po vazhdon", ka njoftuar policia. Zëdhënësi tha se policia u njoftua për të shtënat rreth orës 21:15 të enjten dhe ka dalë me shpejtësi në vendngjarje. Kryetari i Bashkisë së Hamburgut, Peter Tschentscher, ka shkruar në "Twitter" se lajmi ishte "tronditës" dhe shprehi ngushëllimet e tij për të afërmit e viktimave. Dëshmitarët e Jehovahit janë pjesë e një kishë ndërkombëtare, e themeluar në Shtetet e

Bashkuara në shekullin 19 dhe me seli në Uaruik të Nju-Jorkut. Kisha pretendon se ka një anëtarësim prej rreth 8.7 milionë besimtarëve në mbarë botën, me rreth 170 000 në Gjermani. Anëtarët janë të njohur për përpjekjet e tyre për ta shpërndarë besimin e tyre përmes trokitjeve në dyer dhe shpërndarjes së literaturës në sheshet publike. Praktikantet e veçanta të këtij besimi përfshijnë refuzimin për të mbajtur armë, për të marrë transfuzion gjaku, për t'u përlulur flamujve kombëtarë ose për të marrë pjesë në qeverisjet laike.

Rusia ngre dyshime rreth zgjatjes së marrëveshjes mbi eksportin e drithit

MOSKË, 10 MARS - Rusia ka njoftuar se marrëveshja historike që garanton eksportin e sigurt të drithit nga portet ukrainase në Detin e Zi po zbatohet vetëm përgjysmë, duke ngritur dyshime nëse do ta lejonte zgjatjen e marrëveshjes që skadon javën e ardhshme. Marrëveshja, e ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara dhe Turqia korrikun e kaluar, synonte të parandalonte një krizë globale ushqimore, duke lejuar që gruri ukrainas i bllokuar nga sulmi rus të eksportohej në mënyrë të sigurt nga tre porte të Ukrainës. Ajo u zgjat për 120 ditë në nëntor dhe do të rinovohet më 18 mars nëse asnjëra palë nuk e kundërshton këtë. Megjithatë, Moska ka sinjalizuar se do të pajtohet me një zgjatje vetëm nëse hiqen kufizimet që prekin eksportet e saj.

Eksportet bujqësore të Rusisë nuk janë në mënyrë direkte në shënjestër të sanksioneve të Perëndimit, por Moska thotë se sanksionet ndaj sistemeve të pagesave, industrive të logistikës dhe sigurimit krijojnë pengesa për eksportimin e drithërave dhe plehrave të saj kimike. "Ka ende shumë pyetje rreth destinacionit përfundimtar për pjesën më të madhe të grurit. Dhe, sigurisht, pyetjet rreth pjesës së dytë të marrëveshjeve janë të njohura për të gjithë", ka pohuar zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov. Rusia është ankuar se drithi ukrainas i eksportuar në bazë të marrëveshjes shkon në vendet e pasura. "Pjesa e dytë" i referohet një memorandumit mirëkuptimi me OKB-në që lehtëson eksportet ruse të ushqimit dhe plehrave kimike.



Raporti i UNDP-së: Bie kënaqshmëria në punën e qeverisë dhe të kryeministrit

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka publikuar edicionin e 23-të të përmbledhjes Pulsi Publik nga i cili rezulton se ka një rënie të kënaqshmërisë të qytetarëve për performancën e qeverisë, por edhe për atë të legjislativit dhe gjyqësorit. Sipas këtij raporti, ka një rënie prej 7.7 pikë të përqindjes së kënaqshmërisë për performancën e kryeministrit për një periudhë gjashtëmuajore, ndërkaq edhe për performancën e qeverisë ka rënie prej 6.2 pikë të përqindjes

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 MARS - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka publikuar edicionin e 23-të të përmbledhjes Pulsi Publik. Anketa e opinionit të Pulsit Publik bazuar në intervistat e kryera në nëntor 2022 përshkruan gjetjet mbi dhjetë treguesit kryesorë që mbulojnë çështjet socio-ekonomike, mjedisore dhe politike. Si te të gjitha publikimet e mëparshme, të dhënat dhe treguesit janë zbrëthyer sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të hollësishme mbi dallimet në perceptimet për sfidat zhvillimore me të cilat përballen qytetarët në Kosovë. Pulsi Publik 23 regjistron një ulje si në Indeksin e Demokratizimit (ID) ashtu edhe në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike (IBE).

ID-ja aktuale shënon ulje të lehtë prej 0.14 pikësh (1.52) krahasuar me prillin 2022 kur kjo vlerë ishte 1.66 pikë. Sidoqoftë, kjo shifër (1.52) sugjeron se më shumë se gjysma e qytetarëve në Kosovë kanë pikëpamje pozitive për proceset demokratike në Kosovë. Në mënyrë të ngjashme, IBE-ja është ulur për 0.12 pikë krahasuar me prillin 2022. Gjithsej 69 për qind e të anketuarve besojnë se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare. Niveli i kënaqshmërisë me performancën e kabinetit ekzekutiv kapi vlerën prej 41-përqindësh dhe me punën e kryeministrit prej 44.9-përqindësh. Kënaqshmëria me punën e Kuvendit kapi vlerën prej 39.1-përqindësh, kurse kënaqshmëria me kryetarin e Kuvendit të Kosovës ishte 50.8 për qind. Anketa e nëntorit 2022 tregon që niveli i kënaqshmërisë me



presidenten ishte në 56.8 për qind. Ulje të dukshme pati në shkallën e kënaqshmërisë me gjykatat dhe zyrën e kryeprokurorit, në 24.4 për qind dhe 22 për qind përkatësisht, krahasuar me prillin e vitit 2022. Një numër dukshëm më i ulët i të anketuarve ishin të gatshëm të protestojnë për arsye politike në nëntor 2022 (24.2 për qind) sesa në prill 2022 (37.6 për qind). Ky është numri më i ulët i të anketuarve të gatshëm që protestojnë për arsye politike i regjistruar ndonjëherë nga Pulsi

Publik. Papunësia (29.9 për qind), varfëria (21 për qind) dhe çmimet e furnizimeve esenciale (17.4 për qind) u perceptuan si tri problemet kryesore në Kosovë nga të anketuarit kur u kërkuar nga ta të zgjidhnin tri çështjet më problematike. Gjithsejtë 31.2 për qind e të anketuarve besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime. 69 për qind e të anketuarve do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin së shpejti. 8.9 për qind e të anketuarve thanë se dinë shumë për sa i

përket të drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, 26.2 për qind pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 46.1 për qind e të anketuarve thanë se dinë pak për këtë temë. Gjithsejtë 18.8 për qind thanë se nuk kanë njohuri për këtë temë. Gjetjet tregojnë se 80.4 për qind e të anketuarve ndihen të sigurt kur janë jashtë në rrugë, në aspektin e dhunës dhe krimit potencial. Të dhënat e zbrëthyer sipas gjinisë treguan se meshkujt (81.1 për qind) ndihen më të sigurt kur janë jashtë sesa femrat (79.8 për qind).

TABELA 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë

TREGUESIT POLITIK		maj 2019	nëntor 2019	prill 2020	dhjetor 2020	maj 2021	nëntor 2021	prill 2022	nëntor 2022	Trendi
KËNAQSHMËRIA ME KABINETIN EKZEKUTIV	Kabineti Ekzekutiv	17.70%	14.40%	60.70%	21.30%	59.10%	47.60%	47.20%	41.00%	
	Kryeministri	36.50%	20.70%	65.40%	23.00%	59.50%	53.20%	52.60%	44.90%	
KËNAQSHMËRIA ME LEGJISLATIVIN	Kuvendi	19.60%	18.60%	33.40%	22.60%	52.90%	50.30%	50.20%	39.10%	
	Kryetari i Kuvendit	23.60%	20.50%	72.40%	46.70%	59.20%	55.40%	54.40%	50.80%	
KËNAQSHMËRIA ME PRESIDENTEN	Presidentja	20.40%	21.20%	18.70%	33.90%	63.70%	55.20%	58.40%	56.80%	
KËNAQSHMËRIA ME GJYQËSORIN	Gjykata	18.70%	13.60%	24.80%	23.00%	34.60%	33.90%	39.10%	24.40%	
	Prokuroria	16.40%	14.20%	22.30%	23.00%	30.80%	34.00%	37.10%	22.00%	

Shifrat tregojnë rënie të kënaqshmërisë ndaj punës së kryeministrit nga 52.6 % në 44.9 % për gjashtë muaj

Në anketën e opinionit tetor-nëntor 2022, niveli i kënaqshmërisë me performancën e kabinetit ekzekutiv kapi vlerën prej 41-përqindësh, një rënie për 6.2 pikë përqindjeje nga anketa e prillit 2022 kur ishte 47.2 për qind. Niveli i kënaqshmërisë me punën e kryeministrit kapi vlerën prej 44.9-përqindësh, një rënie për 7.7 pikë përqindjeje nga prilli 2022 kur ishte 52.6 për qind”, thuhet në raport. Ndërkaq, në raport me anketën e majit të vitit 2021, kënaqshmëria ndaj performancës së kryeministrit Albin Kurti ishte 59.50 për qind, kurse e performancës së ekzekutivit 59.10 për qind.

ICITAP-i amerikan konfirmon vazhdimin e përkrahjes për Policinë e Kosovës

PRISHTINË, 10 MARS - Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, ka pritur në takim këshilltarin e lartë dhe këshilltaren vendore, në kuadër të programit të ICITAP-it, Departamenti i Drejtësisë së ShBA-së, Timothy Altomare dhe Leonora Berkani. Pjesë e diskutimeve ishte partneriteti i

vazhdueshëm strategjik në mes të DOJ/ICITAP dhe Policisë së Kosovës për avancimin e praktikave efektive për zbatim të ligjit dhe parimet e forta të sundimit të ligjit në polici. Altomare shprehu zotimin për vazhdimin e ofrimit të ndihmës në drejtim të ngritjes profesionale të policisë si dhe

në prioritetizimin e fuqizimit të marrëdhënies me qytetarët. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, u përgjigj me zotimin e tij për vazhdimin e partneritetit me ICITAP-in dhe agjencitë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, duke vlerësuar mbështetjen e tyre në të kaluarën.





Lajçaku e informoi opozitën për pritjet e komunitetit ndërkombëtar lidhur me planin e BE-së

I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, i ka informuar të premtën liderët e opozitës për pritjet e komunitetit ndërkombëtar lidhur me planin e BE-së. Pas takimeve me liderin e PDK-së, Memli Krasniqi, atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe të AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se këto takime kanë përmbushur qëllimin

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 10 MARS - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në ditën e dytë të vizitës së tij në Kosovë ka zhvilluar takim me përfaqësuesit e partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka bërë me dije se me të dërguarin e posaçëm të BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, kanë diskutuar për zhvillimet e fundit politike në Kosovë dhe rajon, posaçërisht për propozimin evropian në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Emisari Lajçak ia ripërsërita qëndrimin tim dhe të PDK-së dhe rezervat që kemi në raport me këtë marrëveshje, e cila, sipas nesh, është e pamjaftueshme dhe mundësi e humbur për një progres final të cilin e kishim pritur të gjithë. Për dy vjet ne kemi mbështetur kryeministrin Kurti në raport me dialogun me Serbinë dhe e kemi inkurajuar të angazhohet në këtë proces.

Fatkeqësisht, neglizhenca e tij, mosdakordimi me partnerët ndërkombëtarë kur duhej, kokëfortësia e tij për t'i dëgjuar propozimet e opozitës, përfshirë pesë pikat tona të deklaruara edhe në Uashington, Bruksel e Kuvend të Kosovës, janë arsyt kryesore që sot kemi një marrëveshje e cila nuk i realizon kërkesat, nevojat dhe qëllimet shtetërore të Kosovës", ka thënë Krasniqi.

Ai ka theksuar se kjo marrëveshje duhet thënë qartë, heq dorë prej arritjes së njohjes së ndërsjellë. "Kryeministri Kurti e ka keqpërdorur legjitimitetin qytetar për t'i bërë një dëm afatgjatë Kosovës, duke ia zvarritur në pafundësi konfliktin e ngrirë me Serbinë. Përfundimisht, sot ne kemi përpara një transformim të marrëveshjes së paralajmëruar dhe kërkuar nga ne dhe partnerët ndërkombëtarë për vite me radhë, nga një marrëveshje finale me njohjen e ndërsjellë në qendër, në marrëveshje të përkohshme me asociacionin në qendër. Dhe, të gjithë ne, i dimë pasojat që mund të sjellë një status-quo e tillë e re në aspektin e integritetit dhe anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare,

përfshirë OKB-në", ka deklaruar Krasniqi, duke shtuar se "sot ne nuk kemi një marrëveshje gjithëpërfshirëse. Sot ne nuk kemi një marrëveshje finale. Sot ne nuk kemi njohje të ndërsjellë. Sot kemi një marrëveshje të përkohshme. Sot kemi nene të caktuara në marrëveshje që rrezikojnë të shkojnë përtej Kushtetutës së Republikës së Kosovës", ka thënë Krasniqi.

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se me emisarin e Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka biseduar për procesin e dialogut dhe propozimin evropian. Abdixhiku ka bërë me dije se i ka thënë Lajçakut se LDK-ja mbështet procesin e dialogut dhe implementimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Në këtë kontekst, Abdixhiku ka thënë se ka kërkuar sqarime nga Lajçaku në lidhje me dy nene të planit evropian. "LDK-ja i jep përkrahje procesit të dialogut me ndërmjetësimin e BE-së dhe me përfshirjen e drejtpërdrejtë të ShBA-së. LDK-ja rithekson se mbështet implementimin e të gjitha marrëveshjeve që janë arritur në këtë proces. LDK-ja përsërit se Kosovës i duhet një marrëveshje e përqendruar në njohje të ndërsjellë dhe se asnjë marrëveshje tjetër nuk garanton normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Heqja dorë nga njohja është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e kryeministrin Kurti dhe e institucioneve të tjera kushtetuese të Kosovës. Në takim, z. Lajçak i kërkoja sqarime në lidhje me tekstin e marrëveshjes së propozuar, në mënyrë të veçantë

në lidhje me preambulën, me nenin 7, nenin 10 dhe me planin implementues të marrëveshjes së tanishme", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur në takim përfaqësuesin special të BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak. Pas takimit Haradinaj ka thënë se nga Lajçaku janë njoftuar në hollësi për procesin e arritur deri më tani lidhur me marrëveshjen në mes të Kosovës dhe Serbisë. "I kënaqur që sot në selinë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, bashkë me kolegë, pritëm në takim përfaqësuesin special të BE-së për dialogun z. Miroslav Lajçak dhe ekipin e tij, të cilët na informuan në hollësi për progresin e arritur deri më tash në përfundimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Haradinaj ka vlerësuar unitetin e shteteve anëtare të BE-së në mbështetje të kësaj marrëveshje. "Shpreha vlerësimin tim për unitetin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian në mbështetje të kësaj marrëveshje. E vlerësova lart angazhimin e jashtëzakonshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në funksion të arritjes së marrëveshjes, rol i cili është jetik në zbatimin e saj", ka shtuar Haradinaj.

Ai ka rikonfirmuar mbështetjen e tij dhe të AAK-së për këtë marrëveshje e cila siguron rrugëtimin e Kosovës drejt integriteteve euroatlantike. "Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës kjo marrëveshje është me interes nacional, pasi që e siguron rrugëtimin tonë të

qëndrueshëm drejt integriteteve euro-atlantike", ka përfunduar Haradinaj.

I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka bërë me dije në një adresim për gazetarë se i ka informuar partitë opozitare në Kosovë lidhur me pritjet e komunitetit ndërkombëtar sa i përket zbatimit të propozimit evropian për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "I informova për procesin, për pritjet e komunitetit ndërkombëtar. Ata shpjeguan qëndrimet e partive të tyre. Pra, e gjitha është pjesë e përgatitjeve për takimin e 18 marsit dhe është shumë e rëndësishme që ata të dëgjojnë nga unë, jo vetëm nga mediet apo në Kuvend. Prandaj, për mua këto takime kanë përmbushur qëllimin", ka thënë Lajçaku për gazetarët në Prishtinë në ditën e dytë të vizitës së tij në Kosovë.

Zyrtari i lartë evropian tha se ishte e rëndësishme për të që të takohej me opozitën në kohën kur blloku evropian po përgatit takimin e radhës të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, që është caktuar të mbahet në Ohër të Maqedonisë së Veriut më 18 mars.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u shpreh i gatshëm ta nënshkruajë marrëveshjen për normalizim me Serbinë gjatë takimit që do të mbahet më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut. "Ai [Kurti] shprehu pritshmërinë e tij që Bashkimi Evropian të punojë në drejtim të përmbylljes së suksesshme të procesit të Marrëveshjes për normalizim përmes nënshkrimit zyrtar të saj në takimin e radhës", u tha në njoftimin e lëshuar nga

Qëndrim Gashi: Kosova duhet ta shfrytëzojë çastin, të hedhë një hap vendimtar

Profesori i Universitetit të Prishtinës dhe ish-ambasadori i Kosovës në Francë, Qëndrim Gashi, thotë se Kosova duhet ta shfrytëzojë çastin për të hedhur një hap vendimtar drejt normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", Gashi tha se një rezultat i lehtësuar nga diplomacia evropiane me ndihmën e diplomacisë amerikane do t'i ndihmojë paqes, sigurisë, përparimit në rajon. Gashi thotë se, me gjithë shqetësimet për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, duke pasur parasysh interesat e qytetarëve të Kosovës, integrimin evropian dhe marrëdhënien me Shtetet e Bashkuara, është e mundur të gjendet një zgjidhje

PRISHTINË, 10 MARS -

Fillimisht të flasim për diplomacinë intensive që po bëhet në rajon, me Kosovën dhe Serbinë. Lajçaku po qëndron në Kosovë dhe më pas do shkojë edhe në Serbi, duke bërë thirrje për nënshkrimin e marrëveshjes, por edhe më e rëndësishme për zbatimin e marrëveshjeve për t'u futur në rrugën e normalizimit të marrëdhënieve. Si e shikoni situatën në këtë pikë?

Qëndrim Gashi: Gjendemi në një moment historik dhe Kosova, udhëheqësit institucionalë të saj, duhet ta shfrytëzojnë këtë moment historik në mënyrë që të shënojmë një hap vendimtar në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Ky nuk është një hap përfundimtar, nuk është marrëveshja finale por, megjithatë, është një hap substancial. Ju kujtoj që një vit pas luftës të agresionit rus në Ukrainë, Evropa gjendet ende në një situatë të tronditur dhe ky moment historik duhet t'i shërbejë edhe Evropës që të jetë e bashkuar në lidhje me çështjet e Ballkanit, integrimin e Ballkanit perëndimor në Evropë si dhe shpresoj e unifikuar edhe në lidhje me Kosovën. Një rezultat që është i lehtësuar edhe nga diplomacia evropiane me ndihmën e

diplomacisë amerikane do t'i ndihmojë paqes, sigurisë, progresit në rajon dhe do ta zbusë nacionalizmin në Beograd i cili është faktori kryesor i destabilitetit aktual në rajon. Por, njëkohësisht, ta zbehë pak edhe populizmin që, megjithatë, mbizotëron edhe në Kosovë.

Z. Gashi, "thembra" e Akilit për këtë zbatim për udhërrëfyesin është pikërisht Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Kosovës i është kërkuar me këmbëngulje zbatimi i Asociacionit, por ndërkohë Kosova ka shprehur shqetësime se një organizëm i tillë, një entitet i tillë, mund t'i ngajë Republikës Serbe (të Bosnjës). Si mund të përputhen këto hezitime që ka Kosova me kërkesat, këmbënguljen e diplomacisë perëndimore për ta zbatuar pikërisht këtë marrëveshje?

Qëndrim Gashi: Unë mendoj që janë tri parime që duhet t'i kemi parasysh. Së pari, interesat e qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie. E dyta, integrimi evropian i rajonit. E treta, marrëdhënia e ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në kuadër të këtyre tri parimeve është e mundur të gjendet zgjidhja dhe ato po ofrohen. Fatkeqësisht, ne kemi kaluar më shumë se një dekadë

duke u vonuar dhe qeveri të ndryshme në Kosovë, kur kanë qenë aktorë të njëjtë në opozitë, kanë pasur qëndrime të tjera, me kalimin në qeveri i kanë ndërruar qëndrimet. Në rregull, mund ta lëmë këtë mënjane, le të jetë kjo analizë e historisë sonë të re por, megjithatë, e rëndësishme është që të shikojmë përpara dhe ta përdorim këtë moment vendimtar. Është e mundur të gjendet zgjidhje dhe ato janë duke u ofruar tashmë.

Disa hapa që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës dhe situata në të cilën ndodhemi pikërisht për këtë propozim, pra për Asociacionin, duket se i ka tendosur marrëdhëniet me Perëndimin, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara. Në këto kushte, si ish-ambasador në një nga vendet më të rëndësishme evropiane (në Francë), si e shikoni këtë vazhdimësi të këtyre marrëdhënieve, si mund të riparohen këto çarje?

Qëndrim Gashi: Ato marrëdhënie riparohen kur e kemi parasysh se interesa në Ballkan nuk ka vetëm Kosova, kanë edhe fuqi të tjera dhe është e mundur që në kuadër të vlerave perëndimore, të parimeve demokratike dhe të lirisë, vlerave të komunitetit euroatlantik të



gjejnë një zgjidhje. Mendoj që, dhe ndoshta disa e mbajnë në mend, ishte një frazë që u tha nga një diplomat i lartë amerikan para dy javësh këtu në Uashington, që Kosova i ka dy kryeqytete, Prishtinën dhe Uashingtonin. Ndoshta do të ishte mirë nganjëherë të kalojmë kohë në të dyja kryeqytetet në mënyrë që këto marrëdhënie të forcohen sepse janë bazë e avancimit të Kosovës dhe sigurisë rajonale. Njëkohësisht, natyrisht Kosova

gjendet në Evropë, prandaj është e rëndësishme që të investohet në fuqizimin e marrëdhënieve me shtetet kryesore të Bashkimit Evropian. Por, po theksoj këtu që është e rëndësishme që këtë moment historik ta shfrytëzojnë edhe ShBA-në dhe BE-në, që sidomos Bashkimi Evropian ta ketë një pozitë të unifikuar sepse Kosova vazhdon ta paguajë faturën për shkakun se janë pesë vende anëtare që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.



Zyra e kryeministrit pas takimit që pati të enjten Kurti me Lajçakun.

Ndërkaq Lajçaku ka thënë për mediet se me Kurtin zhvilloi një takim "konstruktiv, të rëndësishëm dhe shumë të frytshëm". Pas takimit me Kurtin, Lajçaku ka treguar se qëllimi i vizitës së tij dyditore në Prishtinë

është që ta dëgjojë qëndrimin e Kosovës lidhur me propozimin evropian për normalizim, për të cilin palët u pajtuan gjatë takimit të 27 shkurtit në mënyrë që në takimin e radhës në Ohër palët të mund ta bëjnë hapin e radhës, atë të finalizimit të marrëveshjes. Një ditë më parë Lajçaku është takuar edhe me presidenten

Vjosa Osmani. "Në takim u diskutua për zhvillimet e fundit në procesin e dialogut me Serbinë, me ç'rast presidentja Osmani ka ritheksuar se Republika e Kosovës mbetet e angazhuar për një proces, i cili i kontribuon paqes afatgjatë, sigurisë dhe prosperitetit të qëndrueshëm në rajon.

Presidentja Osmani potencoi se aneksi i zbatimit të marrëveshjes bazë, të dakorduar në Bruksel, duhet të jetë në frymën e parimeve të miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, gjegjësisht paprekshmërisë së sovranitetit, integritetit territorial, kushtetutshmërisë dhe funksionalitetit të shtetit të Kosovës", ka njoftuar

Presidenca. Më tej është theksuar se Osmani ka thënë se Kosova mbetet palë konstruktive në procesin e dialogut dhe e koordinuar me partnerët e saj, ndërsa ka ritheksuar se fjalën përfundimtare rreth një marrëveshjeje duhet ta thotë Kuvendi i Kosovës në përputhje me procedurat kushtetuese.



Shënohet 10-vjetori i themelimit të Universitetit të Gjilanit

GJILAN, 10 MARS - Universiteti “Kadri Zeka” në Gjilan ka shënuar 10-vjetorin e themelimit. Në ceremoninë solemne të këtij përvjetori jubilar zëvendësministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Edona Maloku-Bërdyna, ka thënë se është gjithmonë nder të jetë pjesë e këtyre ngjarjeve për t'i shënuar së bashku të arriturat e

institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Maloku-Bërdyna ka theksuar se Universiteti “Kadri Zeka” është universiteti i ri, por me potencial të madh, ndërsa në fjalën e saj të rastit theksin e ka vënë te politikat arsimore të qeverisë për implementimin e standardeve evropiane të cilësisë dhe rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në IAL, heqjen e tarifave për

studentë, rritjen e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor dhe integritimit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Në manifestimin e shënimit të 10-vjetorit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, të pranishëm ishin edhe personalitete politike, akademike, rektorë, prorektorë, profesorë dhe studentë.



UNICEF-i dhe “Devolli Corporation” bashkojnë forcat për fëmijët dhe të rinjtë

PRISHTINË, 10 MARS - UNICEF-i dhe “Devolli Corporation”, si ndërmarrje lidere e biznesit, lansuan një partneritet të ri për t'i rritur shërbimet dhe mundësitë për fëmijët dhe të rinjtë në Kosovë. “Devolli Corporation”, me ndihmën e UNICEF-it, do t'i zgjerojë mundësitë për fëmijët e vegjël në komunitetet e marginalizuara dhe zonat rurale duke mbështetur ngritjen dhe funksionimin e Qendrave të Zhvillimit të Fëmijërisë së Hershme me bazë në komunitet, të cilët ofrojnë mësim të bazuar në lojë dhe përvijë për fëmijët nën 5 vjeç si dhe shërbime për prindërit e tyre. Marrëveshja u nënshkrua në Magurë të Lipjanit, në mes të pronarit Shkëlqim Devolli dhe Nona Zicherman, shefe e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë. Këto aktivitete do ta mbështetnin ofrimin e programeve cilësore të

mësimin të hershëm për 700 fëmijë si dhe do ta mbështetnin angazhimin dhe zhvillimin e aftësive të 400 prindërve. Partneriteti, gjithashtu, do t'i ndihmojë të rinjtë të bëjnë kalime të suksesshme nga shkolla në punë duke ofruar praktikë, mentorim dhe mundësi trajnimi për 500 të rinj përmes platformës “Kosovo Generation Unlimited”. UNICEF-i ka njoftuar se po e vazhdon punën e tij me institucionet e Kosovës dhe me një gamë të gjerë të shoqërisë civile dhe partnerëve të sektorit privat dhe publik për ta promovuar realizimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, me fokus të veçantë në shëndetin dhe edukimin e fëmijëve të vegjël, fuqizimin dhe zhvillimin e aftësive për adoleshentët dhe rininë dhe mbrojtjen dhe përfshirjen e fëmijëve më të cenueshëm dhe më të rrezikuar përgjatë ciklit jetësor.



KFOR-i dhuron donacion për Brigadën e Zjarrfikësve të Drenasit



DRENAS, 10 MARS - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, mori pjesë në pranimin e donacionit nga KFOR-i, të cilën e prezantoi nga Komanda Regionale Lindje (RC-E), koloneli Ozgur Ozgenc me bashkëpunëtorë. Lladrovci para pranimit të donacionit për zjarrfikësit nga KFOR-i mbajti fjalë rasti me ç'rast e falënderoi KFOR-in për bashkëpunimin e ngushtë dhe përkrahjen e ofruar jo vetëm sot,

por nga dita e parë e pranisë së KFOR-it në Kosovë. “Ky donacion me vlerë për zjarrfikësit tanë shton sigurinë e zjarrfikësve kundër rreziqeve në punën e tyre ditore”, ka theksuar Lladrovci dhe ka shtuar se pajisja e kompresorit do të jetë ndihmesë jo vetëm për komunën e Drenasit, por edhe për komunat fqinje. Ai ka vlerësuar zjarrfikësit duke cekur se ata “kanë përvijë, guxim dhe trajnime adekuate për sfidat

e profesionit, për këtë ne jemi të lumtur dhe falënderues për përkrahjen tuaj për djemtë tanë”. “Ju falënderojmë që, krahas sigurisë për të gjithë qytetarët në Republikën e Kosovës, përkrahni edhe shërbimet emergjente, zjarrfikësit. Zjarrfikësit janë të parët në komunën tonë që dalin në vend ngjarje me rastin e rrezikut publik dhe kjo ndihmesë e shton aftësinë vepruese të zjarrfikësve”, ka potencuar Lladrovci.

Rahoveci po bëhet me shesh

Rahovec, 10 mars - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka marrë pjesë të premtën në fillimin e ndërtimit të sheshit qendror të qytetit, projekt i cili do t'i japë pamje tjetër qytetit. “Sheshi ka tre hektarë sipërfaqe dhe do të përmbajë Qendrën e sheshit në formë rrethore; të përshtatshme për organizimin e ngjarjeve të mëdha dhe të

aktiviteteve të ndryshme. Treg ditor modern të mbyllur. Parking nëntokësor me sipërfaqe 4850 m², që do t'i japë zgjidhje problemit të parkingjeve. Parking mbitokësor. Shteg të gjelbër. Shteg për biciklistë. Shteg për këmbësorë. Hapësira të gjelbra. Lokale afariste. Të gjitha këto ndërlihen me

njëra-tjetrën, me qëllim që qasja e qytetarëve në të gjitha pjesët e sheshit të jetë më e lehtë”, ka bërë me dije Latifi. Latifi ka thënë se vlera e projektit do të jetë 3,817,347.79 euro dhe do të jetë investim nga komuna e Rahovecit. “Do të punojmë që të respektohet plani dinamik dhe afati kohor (2025) i realizimit të plotë të



Fillon testimi fizik i të rinjve që synojnë të shërbejnë në FSK

Prishtinë, 10 mars - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka vizituar Qendrën e Palestrës së Sporteve në Kazermën "Adem Jashari", ku ka filluar testimi fizik i të rinjve të cilët kanë aplikuar në konkursin për pranimin e 612 pjesëtarëve aktivë në Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe 388 pjesëtarëve të komponentës rezervë.

Duke u uruar sukses të gjithë kandidatëve, ministri Mehaj ka theksuar se është kënaqësi teksa sheh të rinj e të reja që me kaq vullnet mezi presin t'i bashkohen FSK-së. Ministria e Mbrojtjes si institucion dhe FSK-ja si organizatë garantojnë proces transparent, të monitoruar nga instruktorët e FSK-së,

përfaqësuesit e Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s, organizatat joqeveritare, si dhe mediet, duke mundësuar kështu raportim në kohë reale për e përzgjedhjen e më të mirëve. Forca e Sigurisë së Kosovës është Forcë që synon shërbimin në NATO, andaj dhe ushtarët tanë janë të nivelit të tillë.



Hoti për qeverinë Kurti: Vazhdon privatizimi valë-valë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 MARS - Ish-kryeministri dhe deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se me qeverinë Kurti po vazhdon privatizimi valë-valë. "Mashtrimet po dalin në shesh çdo ditë. Për dhjetë vjet shanin e akuzonin secilin për privatizim, me e pa të drejtë. I mashtronin qytetarët se do të vlerësojnë privatizimet, dhe do të themelojnë Fondin Sovran me asetet e Agjencisë së Privatizimit. Sapo erdhën në pushtet, privatizimi po vazhdon valë-valë", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Hoti ka paraqitur edhe disa fakte që thotë se dëshmojnë mashtrimet e këtij pushteti. "1. Programi zgjedhor i VV-së, faqe 11: 'Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të shuhet dhe asetet e saj do i kalojnë në pronësi Fondit Sovran'. 2. Fjala e

Kurtit në Kuvendin e Kosovës më 17.05.2021, në prezantimin e Programit Qeverisës 2021-2025: 'Agjencinë Kosovare për Privatizim do ta shuajmë dhe do ta transferojmë në agjenci brenda Qeverisë, e do të krijojmë Agjencinë Zhvillimore për udhëheqjen e politikave zhvillimore ndërmjet ministrive dhe agjencive të pavarura'. 3. Programi Qeverisës 2021-2025, faqe 9: 'Do të angazhohemi për krijimin e Fondit Sovran. Fondi Sovran do t'i marrë nën pronësi asetet strategjike të Republikës së Kosovës, për t'i valorizuar ato, për mundësimin e investimeve të jashtme dhe qasjen në tregje të huaja të kapitalit. Po ashtu, Fondi Sovran do ta ketë përgjegjësinë ekskluzive për investimet në rritjen e vlerës së Trepçës, KEK-ut, Telekomit dhe Postës. Si pasojë e kësaj, do të shuajmë Agjencinë Kosovare për Privatizim me anë të transferimit të saj në agjenci brenda Qeverisë"', ka thënë Hoti.



Rritet mbitërheqja e parave nga bankat, në vitin 2022 qytetarët 415 milionë euro 'overdraft'



PRISHTINË, 10 MARS - Instituti GAP ka publikuar të dhëna për mbitërheqjet e qytetarëve në bankat në Kosovë, ndërsa del se gjendja e mbitërheqjeve nga bizneset dhe ekonomitë familjare në fund të dhjetorit 2022 ishte rreth 415 milionë euro. GAP-i në publikimin e të dhënave nga 2012 deri në 2022 thekson se gjatë vitit 2022 Kosova është përballur me një normë të lartë të inflacionit. Një ndër format më të shpejta dhe më me pak procedura për bizneset dhe qytetarët për të huazuar nga bankat mbetet ajo e

mbitërheqjes/overdraftit. "Të dhënat nga BQK-ja tregojnë se gjendja e mbitërheqjeve nga bizneset dhe ekonomitë familjare në fund të dhjetorit 2022 ishte rreth 415 milionë euro, apo për rreth 143 milionë euro më e lartë se në dhjetor 2021", thuhet në të dhënat e GAP-it. Sipas GAP-it, referuar statistikave të Bankës Qendrore të Kosovës, në vitin 2012 qytetarët në banka kanë hyrë 176.8 milionë euro në 'overdraft', 198.9 milionë euro në vitin 2013, 199.4 milionë në vitin 2014, në vitin 2015 kanë hyrë 203.4

milionë euro. Ndërkaq, në vitin 2016 qytetarët kanë mbitërhequr nga banka 198.4 euro, në 2017 168 milionë euro, në vitin 2018 kanë hyrë overdraft 152.2 milionë euro, në vitin 2019 138.9 milionë euro, në vitin 2020 kanë hyrë overdraft 143.2 milionë euro, gjersa në vitin 2021 kanë mbitërhequr nga banka 271.6 milionë. Për dallim nga viti 2021, kur qytetarët kanë mbitërhequr nga bankat 271.6 milionë, në vitin 2022 qytetarët kanë marrë overdraft 414.8 milionë euro, për rreth 143 milionë euro më shumë se në dhjetor 2021.

Prishtinasi gjen një kuletë në rrugë me para dhe e dorëzon në polici

PRISHTINË, 10 MARS - Një qytetar i Prishtinës ka dorëzuar në Stacionin Policor Qendër një kuletë me para dhe dokumente. "Sot zyrtarëve të stacionit policor Qendra në rrugën "Tringë Ismajli" në Prishtinë, një qytetar V.

Ramadani ua ka dorëzuar një portofol (që e kishte gjetur në rrugë), ku kishte një shumë parash dhe dokumente personale. Menjëherë është ftuar në stacion pronari i portofolit dhe konform procedurave i njëjti ka

pranuar portofolin, paratë dhe dokumentet. Duke çmuar këtë gjest human, falënderojmë të gjithë qytetarët për bashkëpunimin e vazhdueshëm me Policinë e Kosovës", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Lekaj: AAK-ja, kategorike kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 MARS - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pa Lekaj, ka thënë se paralajmërimi për rritjen e çmimit të energjisë elektrike është absurd, ndërsa nuk përjashtoi mundësinë edhe të mbajtjes së protestave. Lekaj në një konferencë për medie mbajtur të premten ka theksuar se AAK-ja kategorikisht është kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike.

Ai ka thënë se janë disa arsye pse ku subjekt politik mendon se rritja e çmimit të energjisë prej 14-përqindësh nuk duhet të ndodhë. “Duke marrë parasysh subvencionet e ndara nga qeveria vitin e kaluar për zbutjen e ndikimit të rritjes së çmimit të energjisë, nuk shihet e arsyeshme të ketë rritje të dytë të çmimit dhe aq më pak

të ndodhë të ketë rritje në vlerë prej 14-përqindësh. Madje ne kemi pritur ulje apo kthim të çmimit të tarifave të vjetra e jo rritje të dytë. Qeveria Kurti vitin e kaluar subvencionoi bizneset, ndërsa konsumatorëve familjarë, pavarësisht subvencionit, iu rriten tarifat për më shumë se 100 për qind. Pra, pësuan shumica e qytetarëve, sepse zgjidhjet nuk ishin adekuate”, ka thënë Lekaj.

Ai ka theksuar se arsye tjetër është se KEK-u është në gjendje stabile, ku ka esportuar miliona euro energji dhe, sipas tij, nëse kjo energji e eksportuar nga KEK-u nuk zberthehet në të mirë të qytetarëve, cila është arsyeja e rritjes së çmimit të energjisë. “Jemi në stinën e pranverës në fillim të vitit 2023 dhe qeveria ka hapësirën kohore e buxhetore që të lidhë marrëveshje me shtetet fqinje për shit-blerje të energjisë dhe që përmes mirëmbajtjeve,



renovimit dhe rregullimit të gjeneratorëve e sistemit elektro-energjetik, të krijojë stabilitet shtetëror, ku Kosova do të sigurohet në aspektin e energjisë për vitin 2023-2024”, është shprehur Lekaj. Deputeti i AAK-së ka theksuar se qeveria duhet ta dijë se qytetarët e vendit janë të

lodhur nga shtrenjtimi i secilit artikull dhe jetesa është bërë e vështirë, ku një familje nuk po mund ta sigurojë as shportën familjare. “Vetëm të mendosh edhe një rritje tjetër të çmimit të energjisë nuk është normale dhe as e arsyeshme. Nëse ndodh kjo rritje, qytetarin e vendos në varfëri të skajshme

dhe në luftë për ekzistencë e mbijetesë. Nëse ndodh kjo rritje, atëherë qëllimshëm po nxitet dhe stimulohet edhe më shumë ikja e qytetarëve nga vendi. Prandaj, mbi këto që thashë, ne si AAK jemi kategorikisht kundër kësaj rritjeje dhe nuk do ta lejojmë që kjo të ndodhë”, ka deklaruar Lekaj.

Me mbështetjen e Gjermanisë, Kosova nis një projekt kundër pastrimit të parave

Prishtinë, 10 mars - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të premten në takim drejtoreshën e përgjithshme të Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ), Frauke Bachler, drejtorin për Evropën Juglindore të IRZ-së, Frank Hupfeld dhe ekspertët doktorin e Shkencave të Drejtësisë, Stefan Trunk dhe Thomas Seidel, të dy me përvojë shumëvjeçare në prokurori, respektivisht polici dhe njësi të inteligjencës financiare në Gjermani, të shoqëruar nga ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde.

Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ) është themeluar me iniciativën e Ministrisë Federale të Drejtësisë në vitin 1992. IRZ mbështet më shumë se 20 partnerë në projekte reformatore në fushën e



drejtësisë, duke dhënë këshilla juridike në përgatitjen e ligjeve, themelimin dhe zhvillimin e institucioneve, por edhe përmes promovimit e

trajnimeve në shumë fusha. Ajo zbaton edhe projekte të Bashkimit Evropian. Ekspertiza e tyre kësaj radhe, me kërkesë të Qeverisë së

Republikës së Kosovës, do të fokusohet në luftimin e pastrimit të parave, duke prodhuar kështu rezultat të drejtpërdrejtë dhe

rekomandime të qarta brenda përpjekjeve për hartim dhe miratim të Strategjisë Shtetërore kundër Korrupsionit deri në fund të vitit 2023.

Kryeministri Kurti i njoftoi të pranishmit me përpërimin ekonomik dhe demokratik dhe arritjet në fushën e sundimit të ligjit dhe luftimit të korrupsionit brenda dy vjetëve të fundit. Diskutimi u fokusua edhe në nevojën e shqyrtimit të kornizës ligjore dhe institucionale me qëllim të luftimit të pastrimit të parave, fuqizimit të institucioneve me qëllim të ndjekjes së krimeve dhe luftimit të ekonomisë joformale. Përfaqësuesit e IRZ-it konfirmuan gatishmërinë e tyre për asistencë dhe bashkëpunim edhe më të thellë, teksa përgëzuan qeverinë për nismat ligjore për luftimin e korrupsionit dhe luftën kundër pastrimit të parave.

Tri raste të falsifikimit të parasë brenda 24 orë në Prishtinë

PRISHTINË, 10 MARS - Policia e Kosovës ka njoftuar se në 24 orët e fundit në rajonin e Prishtinës janë raportuar tri raste të falsifikimit të parasë. Sipas policisë, një rast ka ndodhur në rrugën “Avdyl Frashëri”. “Ankuesja femër kosovare ka njoftuar se nga një person është deponuar një kartëmonedhë në vlerë 50 euro e falsifikuar.

Kartëmonedha është sekuestruar për hetime të mëtejshme”, thuhet në njoftim. Rasti tjetër ka ndodhur në rrugën “Enver Maloku”. “Ankuesja femër kosovare ka njoftuar se ka hasur në 1x50 euro e dyshuar për falsifikim. Kartëmonedha është sekuestruar për hetime të mëtejshme”. Ndërsa rasti i tretë ka ndodhur në

magjistralen Prishtinë-Ferizaj. “Ankuesja femër kosovare ka raportuar se nga i dyshuari mashkull kosovar janë deponuar 659x2 euro dhe 10x1 euro monedha të dyshuara si të falsifikuara. Monedhat janë sekuestruar për ekzaminim dhe procedura të mëtejshme hetimore”, thuhet në njoftimin e policisë.



Modeli ekzistencialist dhe karakteret në romanet 'I huaji', 'Procesi' dhe 'Vdekja në ajër të pastër'



LEONORA HAJRA

Konkordancat dhe diskordancat

(filozofia, tematika dhe karakteri)

1.1. Konteksti ideofilozofik

Zhvillimet shoqërore, politike dhe filozofike jo rrallë kanë krijuar figura kontroverze, utilitare apo edhe kritike si frymë të shprehura në vepra letrare. Individu krijues është pjesë e pashkëputshme e ekosistemit ku gjallon, ai jep e merr nga ky ekosistem, duke përzier shpesh faktin e fiksonin, pra realen me imagjinaren në drejtim të krijimit të një bote të re që vazhdimisht është në përballje qoftë edhe në mënyrë implicite me ekzistuesen.

Ekzistencializmi, observimi që realizon ai, duke përmbysur idenë se thelbi, esenca i paraprind ekzistencës, për të provuar kështu të kundërtën, njeriun si skulptor që vizaton konturën e tij, pra si qenie e lirë që ndërton identitetin e tij në një vazhdë kontinuale, ka bërë që të etiketohet si një ndër rrymat filozofike më me ndikim në botëpërciptimin e artit të shek. XX. Njeriu është vazhdimisht në sfidë me botën që e rrethon. Përpjekja për ta kuptuar dhe për ta interpretuar atë modelon identitetin e tij. Në këtë terren ai ndodhet gjithmonë para zgjedhjeve dhe janë pikërisht këto zgjedhje të cilat ndërtojnë atë që Kirkegardit e quan 'ekzistencë të vërtetë'. Sado që Sartri, duke theksuar nevojën që individit të zgjedhë duke menduar pasojat, pra si një i lirë me

përgjegjësi, nuk duket se refuzon kategorikisht shoqërinë siç bën Kirkegardit duke e quajtur atë thjesht spektator, nuk është e vështirë të vërehet se realisht deduksioni i tyre zë fill në të njëjtën pikë: njeriu ekzistencialist është produkt i zgjedhjeve të veta.

I huaji, *Procesi* dhe *Vdekja në ajër të pastër*, ani pse vepra të periudhave e të letërsive të vendeve të ndryshme, mund të cilësohen si vepra me premisa ekzistencialiste, që në qendër vendosin njeriun dhe natyrën e ndërtojnë të tij në marrëdhënie me botën dhe shoqërinë. Nevoja e krahasimit të këtyre tre romaneve derivon si rrjedhojë e pikëtakimeve që venerohen mes tyre në rrafshin e ideve filozofike ekzistencialiste, me modelimin e karakterit si inferioritet, censurimin e lirisë nga instancat e larta, absurdin si domen që i kundërvihet logjikës, erosit si ndjenjë biologjike e Zotit si moskzistencë. Siç shihet, këto konkordanca (pikëtakime) modelohen në rrafshin ideopërmbajtësor dhe janë ato shkëndijat e para që bëjnë të lindë ideja e krahasimit. Natyrshëm aty ku shfaqen konkordanca midis strukturimit të elementeve të romaneve është e rëndësishme të specifikohen edhe diskordancat, pra pikat në të cilat këto romane divergojnë, largohen, krijojnë autencitetin e tyre. Të tre këto romane paraqesin karaktere unike në letërsi të cilat vazhdimisht janë diskutuar pikërisht për shkak të panatyrshmërisë me të cilën është veshur qoftë qenia e tyre, qoftë edhe ambienti, shoqëria ku jetojnë. Merso, Jozef K. dhe A B ndërtojnë

gjithë linjën ideofilozofike të tri veprave kur vështrohet ndjeshmëria dhe reagimi i tyre në raport me akuzën që ngrihet ndaj tyre, (pa)fajësia, kompleksi i tjetrit, koncepti i lirisë dhe intimita.

1.2. Faji i individit

Njeriu jeton i ngjeshur me një shumësi zgjedhjesh, por edhe me një botë që e sfidon qenësinë e tij në vazhdimësi, prandaj edhe ai nuk mund të mendohet si tërësisht i shkëputur nga ajo. Këto tri romane dëshmojnë për këtë raport e përballje që në ekzistencë harxhon energjinë e njeriut, zvetënon idenë e tij për marrjen e jetës me një spontanitet. Fajësia, (pa)fajësia dhe pafajësia përbën një triadë mjaft ambigje, por edhe një përfaqësim crucial në modelimin e karaktereve. Ambiguiteti i saj do parë në konceptimin e fajësisë. Në këtë pikë konkordancë e tre romaneve është faji, në një anë si perceptim psikik i individit në raport me një vepër të kryer nga ana e tij, në anën tjetër si perceptim i shoqërisë që veprën e kryer e cilëson si kundërshtuese ndaj normave të përcaktuara nga ajo. Të tre karakteret shquhen për ndeshjen e tyre me këtë kategori që, në thelb, bëhet orientuese e fatit të tyre final.

Fillimi i një kapitulli zakonisht është i zgjedhur e befasues për pritjen e lexuesit.^[1] Kjo dëshmohet më së miri me *Procesin* e Kafkës i cili nis me një frazë që aq sa është e drejtpërdrejtë, aq edhe e bën lexuesin të njohur me një situatë atipike: *Me gjasë, dikush kishte shpifur kundër Jozef K., sepse një mëngjes atë e arrestuan, megjithëse*

Skishte bërë gjë.^[2] Që nga kapitulli i parë autori luan aq shumë me të pazakonshmen, me atë çka është irracionale për mendjen njerëzore, sa lexuesi pashmangshëm e gjen veten në një ambient kompleks absurd. Jozef K. etiketohet si i arrestuar për diçka që nuk dihet e të cilën nuk e kupton në asnjë rast, as kur ndodhet në gjykatë, as kur zë avokat, as kur dënohet me vdekje. Pra, në qendër të veprës qëndron tema e njeriut të përndjekur (gjykuar) pa faj, si esencë për të dhënë transformimin e njeriut brenda sistemeve totalitare, pushtetin e tyre në psikikën e njeriut.


Fajësia e Jozef K. del të jetë përcaktuar nga instanca të larta ndaj të cilave njeriu insiston të lirohet. Ani pse pushteti i tyre nuk realizohet me burgosjen e tij fizike, vihet theksi te psikika e tij, në thelb e burgosur me ankthin e humbjes së lirisë, çka bën që gjithë romani të shfaqet si tendencë për ta rifituar lirinë, për t'u kthyer në situatën zero. Parë në këtë rrafsh faji, është e vërteta e parë nga perspektiva e autoriteteve, ndërsa në konceptimin e Jozef K. ai kthehet në pengesë për t'u çliruar.

Në diskordancë me Jozef K. që del si viktimitë tipike e një fuqie që shpif kundër tij, faji i dy karaktereve të tjera, Mersos dhe A B, rrjedh nga kryerja e kriminit që ka lindur qysh në familjen e parë biblike. Konkordanca e tyre qëndron pikërisht në mënyrën se si modelohen me një naivitet të theksuar larg çdo modeli të kriminelit të zakonshëm, larg çdo puro-vrasësi. Vrasja që kryen Merso del e pamotivuar nga ndjenja

vetjake. Sipas disa studiuesve, ajo nuk lidhet me identitetin e viktimitës, por me etninë e tij. Kështu, në esenë e Jeffrey Meyers *Kafka dhe Kamyja*, theksohet se Kamyja këtu përshkruan se si, nën kolonizmin francez, algjerianët duken si 'bllaqe gurësh ose pemësh të ngordhura, gjëra të parëndësishme, të shpenzueshme dhe meqenëse vrasja e një arabi në këtë shoqëri koloniale nuk ka shumë rëndësi, gjykata duhet të gjejë arsye të tjera për ta dënuar atë dhe përdor karakterin e tij të panatyrshëm për ta shpjeguar sjelljen e tij të egër.

Në planin tjetër A B si narrator karakter me attribute të theksuara filozofike modelohet i atillë që vetëdija e tij ekzistencialiste ndeshet me hapësirën tipike shqiptare. Krimi i tij realizohet spontanisht në një ditë kur ai del me pushkën e tij në gjueti për lepuj, rastis që atje me "mendjen se po qëllon lepuj" të vrasë pikërisht gjaksin e tij, njeriun që 25 vjet më parë i kishte vrasë të atin, si dhe të birin e gjaksorit, ndërsa traumatizon edhe të tretin, birin tjetër, me situatën makabre në të cilën e bën dëshmitar.

Kur shikohet në dritën e fakteve është i pakontestueshëm faji që ka Merso në vrasjen por, paradoksisht, me qenësinë e tij të brishtë para një shoqërie që e akuzon atë për sjelljen e tij gjakftohtë në varrimin e së ëmës dhe shmang çdo vëmendje nga skena e kriminit të vërtetë – vrasja, lexuesi s'mund të mos ndiejë një simpati për Merson karshi neverisë që ngjall deduksioni i shoqërisë, ku nuk ka asnjë të vetëm që nuk ndihmon për ta çuar heroin drejt kriminit dhe dënimit me vdekje.^[3]



Veton Zymberi, redaktor i sportit

Sot dy ndeshje në Superligë, derbi zhvillohet të hënën

PRISHTINË, 10 MARS - Prince Caffè Superliga e Kosovës në basketboll po shkon drejt fazës së fundit të garave të rregullta. Takimi i parë i xhiros së 25-të do të zhvillohet në mes të Pejës dhe Vëllaznimit, dy skuadra me traditë në basketbollin e Kosovës. “Verdhezinjtë” janë këndellur me trajnerin e ri izraelit, ndërsa në këtë edicion numërojnë 17 fitore e shtatë humbje, ndërsa kuqezinjtë që synojnë “play-off”-in kanë tetë fitore e 16 humbje. Dueli i dytë i sfidës së shtunës është ndërmjet Rahovecit dhe Bashkimit. “Vreshtarët” ndodhen në vendin e fundit me tri fitore e 21 humbje, kurse

prizrenasit kanë 11 fitore e 13 humbje në pozitën e pestë. Të dielën përballen kampioni Golden Eagle Ylli dhe Ponte Prizreni, që nuk po kalon në formë të mirë në ndeshjet e fundit. Therandasit kanë 17 fitore e shtatë humbje, ndërsa e kundërta është me prizrenasit që kanë shtatë fitore e 17 humbje. “Ajka” për në fund, ku të hënën përballen Sigal Prishtina dhe Trepça. Këto dy skuadra, përveç që janë ndeshur tri herë gjatë garave të rregullta, janë përballur edhe në dy finale. Prishtinasit i mundën në Superkupë, kurse mitrovicasit iu kundërpërgjigjën për Kupë. “Bardhekaltrit” janë në

vendin e parë me 18 fitore e gjashtë humbje, kurse “xehetarët” janë në vendin e katërt me 15 fitore e nëntë humbje.

SUPERLIGA - Java 25

Të shtunën takohen:
17:00 Peja - Vëllaznimi
19:00 Rahoveci - Bashkimi

Të dielën takohen:
19:00 Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni

Të hënën takohet:
18:30 Sigal Prishtina - Trepça



‘Dardanët’, gati për nisur rrugëtimin drejt ‘UEFA Euro 2024’

PRISHTINË, 10 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll po e nis një vit jashtëzakonisht të rëndësishëm, në të cilin aspirohet kualifikimi historik në një garë të nivelit të lartë ndërkombëtarë, siç është Kampionati Evropian që zhvillohet vitin e ardhshëm në Gjermani, raporton “Futbolli.info”. Zakonisht kapitenët janë ata që prijnë për kah vet-mohimi e motivi dhe i tillë është edhe rasti i kapitenit tonë, Amir Rahmani, i cili po kalon vitin më të mirë të karrierës me klubin e tij Napoli.



Në fakt, Rahmani po shkon sigurt drejt titullit të kampionit të Italisë me Napolin dhe duket se pas suksesit me klubin, radhën do ta ketë suksesi me Kombëtaren. Duke folur për

ambicjet e tij me ekipin kombëtar, Rahmani ndër të tjera ka thënë: “Absolutisht që është një vit i rëndësishëm për ne dhe kombëtaren e Kosovës dhe në mendjen tonë nuk ka

asnjë opsion tjetër përveç synimit të qartë që e kemi e që është kualifikimi në Euro. Jemi të vetëdijshëm se nuk do të jetë mision i lehtë, se kemi grup të fortë e kundërshtarë cilësor, por ka ardhur koha që ne të dëshmojmë veten dhe formën që e kemi në klube ta bartim edhe në ekipin Kombëtar e kësaj të arrijmë suksesin që aq gjatë po e presim”. Në anën tjetër Zhegrova si zakonisht është shumë optimist dhe nuk e fshihet atë. “Do të kualifikohemi në Euro. Jam i sigurt për këtë. Kemi gjithë kualitetin që na duhet dhe

jemi rritur si ekip, kështu që jam i sigurt që do të kualifikohemi në Kampionat Evropian. Përkrahja nga Federata dhe nga Presidenti është e madhe dhe nuk na mungon asgjë për ta realizuar këtë synim. Personalisht po ndihem në formë shumë të mirë dhe jam i gatshëm ta ndihmoj ekipin sa më shumë”, ka deklaruar Zhegrova. Përndryshe Kombëtarja e Kosovës do të grumbullohet me 20 mars, kurse dy ndeshjet e para kualifikuese do t’i zhvillojë me 25 mars kundër Izraelit dhe më 28 mars kundër Andorrës.

Vazhdon Superliga e hendbollisteve, lideri udhëton në Ferizaj



PRISHTINË, 10 MARS - Pas pushimit për shkak të aktiviteteve të kombëtareve të reja, këtë fundjavë zhvillohet xhironja e radhës në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencën e femrave. Në program është xhironja e 12-të. Të shtunën janë tri ndeshje. Vushtrria llogaritet favorite në derbin lokal me Samadrexhën. Kjo ndeshje luhet prej orës 17:30. Shqiponja e pret Dukagjinin (14:30), ndërsa

Ferizaj e pret Jusuf Gërvallën (14:30). Edhe në këto ndeshje skuadrat vendase janë favorite. Të dielën janë dy ndeshje të tjera. Kampioni dhe lideri, Istogu, sfidohet në Ferizaj nga Kastrioti. Kjo ndeshje luhet prej orës 16:00 dhe e mbyll xhiron e 12. Vëllaznimi -Prishtina zhvillohet prej orës 12:30 dhe mund të jetë prej ndeshjeve më të mira të xhiros. Në Ligën e Parë të hendbollisteve është java e

dhjetë. Të shtunën janë ndeshjet Drita – Samadrexha (19:00) dhe Dukagjini – Ulpiana (14:00). Prizreni – Istogu (16:00) dhe Lepenci – Vjosa (17:00) janë ndeshjet e së dielës. Në Ligën e Parë të hendbollisteve të shtunën janë tri ndeshje të javës së 13: Vjosa – Trepça (15:30), CLICK – Llapusha (11:00), Drita – Prizreni (17:00). Deçani – KEK-u është ndeshja që luhet të dielën me fillim nga ora 14:00.

Edon Sadriu, “Ylli i javës” në Superligë

FERIZAJ, 10 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë të japin çmimin “Ylli i javës”. Ky çmim për javën e 24-t në Albi Mall

Superligë i ka takuar futbollistit të FC Ferizaj, Edon Sadriu. “Është nder të shpallësh më i miri i javës në Albi Mall Superligë. Ky shpërbim është falë ndihmës

së bashkëlojtarëve, shtabit teknik dhe përkrahjes së tifozëve tanë. Me këtë seri pozitive, me lojën dhe përkushtimin që po tregojmë, besoj se Ferizaj do ta arrijë

objektivin për mbetjen në Superligë. Na pret një luftë shumë e vështirë deri në fund të kampionatit”, ka thënë Edon Sadriu për faqen zyrtare të FFK-së.



Mgbeike, MVP e javës në Ligën Unike

PRISHTINË, 10 MARS - Ka përfunduar faza e rregullt e garave në Ligën Unike të Femrave. Prishtina mundi Penzën në udhëtim për ta siguruar vendin e tretë, ndërsa në fitoren e

prishtinaseve më e mira ishte Sarah Mgbeike me 23 pikë, nëntë kërcime dhe gjashtë asistime. Mgbeike shpallet MVP e kësaj jave, ndërsa në fitoren e prishtinaseve kontribuoi

Kaela Hilaire me 15 pikë e 15 asistime, por edhe tri kërcime. Bashkimi siguroi vendin e parë pas fitores ndaj Tiranës, ku u dalluan Arbnore Përçuku me 16 pikë, shtatë kërcime dhe 12

asistime, si dhe Khadija Haywood me 19 pikë, nëntë kërcime dhe tri asistime. Partizani mundi Flamurtarin, ku më e mira ishte Ornela Lalaj me 20 pikë, katër kërcime dhe tri asistime.



Donjeta Sadiku rrezikon ta humbë botërorin e boksit

Prishtinë, 10 mars - Nga 14 deri më 26 mars në Nju-Dehli të Indisë do të mbahet Kampionati Botëror i Boksit për kategorinë seniore. Kosova në këtë kampionat synon të marrë pjesë me boksierin Donjeta Sadiku, por kjo ende nuk është konfirmuar për shkak se India po heziton të lëshojë viza për Sadikun dhe ekipin e saj. Të shqetësuar me situatën e krijuar dhe me mundësinë e humbjes së mundësisë për të marrë pjesë në këtë kampionat janë shprehur drejtuesit e Federatës së Boksit si dhe ata të Komitetit Olimpik të Kosovës.



Sekretari i Federatës së Boksit, Latif Demolli, ka thënë për "KosovaPress" se kjo nuk është hera e parë që India pengon Kosovën të marrë pjesë në gara ndërkombëtare sepse një gjë të tillë e kishte bërë edhe në vitin 2018, por se shpreson që Kosova të mos e pësojë edhe kësaj radhe. "Ne kemi aplikuar në dhjetor të vitit të kaluar për pjesëmarrje në Kampionatin Botëror në Indi me të gjithë dokumentacionin e duhur për viza dhe ky është muaji i tretë. Ne kemi të njëjtat fjalë. Ne çdo ditë i dërgojmë emaile Federatës së Indisë, Federatës Botërore IBA, të njëjtën përgjigje na e kthejnë dhe përgjigja e fundit është dje, ku na thuhet se jemi në diskutime ende... Neve Ministria e Punëve të Jashtme

(e Indisë) edhe viteve të mëparshme na i kandalur vizat për Kosovën për arsye se nuk e njohin shtet", ka thënë Demolli. Zëdhënësi për medie i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Kushtrim Krasniqi, thotë se janë në komunikim intensiv me Komitetin Olimpik të Indisë, duke kërkuar që Donjeta Sadikut t'i mundësohet pjesëmarrja në Botëror me simbolet e shtetit të Kosovës. "Problemi tashmë dihet, India nuk e njeh pavarësinë e Republikës së Kosovës dhe kjo është një çështje prej vitesh që ndikon në pjesëmarrjen e sportistëve tanë në shtetin e Indisë. India, përveç që nuk e lejon pjesëmarrjen, ajo e ka zgjedhur një mënyrë tjetër që mos t'u japë viza sportistëve tonë, konkretisht në këtë rast të Donjeta Sadikut, e cila po përballlet për herë të dytë me problemin e njëjtë... Si

Komitet Olimpik i Kosovës jemi në kontakt të vazhdueshëm me Federatën e Boksit të Kosovës, por edhe me Komitetin Olimpik të Indisë, nga të cilët kemi kërkuar ndihmë në këtë drejtim në mënyrë që t'i lehtësohet marrja e vizës Donjetës dhe ajo të paraqitet me simbolet shtetërore dhe me të gjitha të drejtat e barabarta në Kampionatin Botëror", ka deklaruar Krasniqi.

Krasniqi shton se Sadiku është një ndër boksieret favorite për ta fituar edhe medaljen e artë në këtë kampionat, andaj fakti që potencialisht në këtë shtet do të duhej të ngrihej flamuri i Kosovës mund të paraqesë një pengesë për shtetin organizator. "Forma e mirë që është duke e përjetuar Donjeta, sidomos nga viti i kaluar, kur fitoi medaljen e bronzit të botës, pastaj medaljen e bronzit të Evropës, është dëshmi e mirë që nëse ajo merr pjesë në këtë Kampionat Botëror është kandidate për të fituar jo vetëm medaljen e bronzit por, ndoshta, edhe medaljen e artë... Prandaj kjo do të ishte mundësi e mirë për Federatën e Boksit, por edhe për Donjetën që të fitojë një tjetër medalje botërore... India, përveç që nuk e njeh shtetin e Kosovës, një medalje e tillë do të bënte që simbolet tona shtetërore, flamuri ynë të valonte në një shtet të madh siç është India", ka shtuar ai.

Milwaukee gjithnjë lider, Memphisi fut kampionët e Golden States në krizë

MILWAUKEE, 10 MARS - Ekipi i Milwaukee Bucksit mbron kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 118-113 ndaj Brooklynit, duke korrur fitoren e tretë radhazi. Portis me 28 pikë e Lopezi me 24 pikë ishin ata që bënë diferencën për ekipin e Bucksit. Fiton edhe Sacramento, që falë një "triple double" të Sabonis (24 pikë, 13 rebounde e 10 asistime), mundi



me rezultat 122-117 New Yorkun. Skuadra e Memphisit rikthehet te fitorja dhe mposht 131-110 kampionët e Golden States, që pësuan humbjen e tretë radhazi. Të gjithë titullarët e Memphisit realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua

Jones me 22 pikë e 11 asistime. Ekipi i Utah Jazzit, falë 31 pikëve të Markkanenit, mundi me rezultat 131-124 Orlandon, ndërsa Indiana fitoi me rezultat 134-125 ndaj Houstonit pas kohës shtesë (Haliburton 29 pikë).

REZULTATET

Detroit - Charlotte	103-113
Indiana - Houston	134-125
Orlando - Utah Jazz	124-131
Memphis - Golden State	131-110
Milwaukee - Brooklyn	118-113
Sacramento - New York	122-117

Howe: Newcastle synon pozitën e katërt

Trajneri i Newcastle Unitedit, Eddie Howe, këmbëngul se rruga e ekipit që ai drejton është përfundimi në katërshen e parë të Premierligës. "Laraskat" do të takohet me Wolvesin të dielën

në tentim për t'iu kthyer rezultateve pozitive pasi kanë humbur vendin e katërt dhe trajneri Howe ka treguar synimet e ekipit. "Ekziston një besim se ne mund të fitojmë përsëri dhe ne duhet shumë

shpejt për ta përmbushur këtë qëllim. Unë kurrë nuk kam qëndruar këtu dhe nuk kam folur për iu përket objektivave dhe katërshes së parë, por ne kemi folur për atë që mund të arrijmë dhe

cilësinë në grupin tonë dhe nuk do të ndryshoj tani", ka thënë Howe. "Gjatë çdo sezoni ka momente të vështira dhe ka pjesë ku ju për ndonjë arsye nuk i fitoni ndeshjet që ndoshta duhet

dhe ndonjëherë fitoni ndeshje që nuk duhet". "Ne jemi në të parën dhe këtu duhet të jesh i fortë mendërisht dhe të dish se do të ndryshojë", përfundoi trajneri i Newcastle.

SHKURT

Taekwondisti Arbër Bajra, i kualifikuari i parë për Lojërat Evropiane 2023

Taekwondisti Arbër Bajra është sportisti i parë i kualifikuar nga Kosova në Lojërat Evropiane që prej 21 qershor deri më 1 korrik mbahen në Krakovia dhe Malopolska të Polonisë. Konfirmimi për Bajrën ka ardhur nga Komiteti Olimpik i Evropës dhe Unioni Evropian i Taekwondosë. Bajra do të garojë në kategorinë deri në 80 kilogramë. Sportistët e taekwondosë kualifikohen për në LE 2023 bazuar në renditjen e Federatës Botërore të Taekwondosë, ndërsa nga një Komitet Olimpik Kombëtar kualifikohet vetëm një për kategori. Garat e taekwondosë në Lojërat Evropiane 2023 janë edhe kualifikuese për Lojërat Olimpik Paris 2024. Krahas taekwondosë, KOK-u pritet të përfaqësohet edhe me sporte të tjera, disa prej të cilave llogariten edhe si Kampionate Evropiane dhe kualifikuese për Lojërat Olimpik "Paris 2024".

Galtier pritet të shkarkohet, PSG-ja sytë kah Zidane

Disfata e rëndë përballë Bayern Munchenit nuk mund të kalonte në heshtje në Francë. I pari nën akuzë ka përfunduar trajneri Christophe Galtier, i cili me këtë eliminim praktikisht firmosi largimin e tij nga Parisi. Ashtu siç pritej, mediet kanë nisur të aludojnë se kush do të jetë pasuesi i tij në krye të PSG-së. I pari në listë është Zinedine Zidane, edhe kjo ishte e pritshme, por "Zizu" kërkohet nga disa ekipe. Tekniku francez shihet edhe në shtëpinë e Real Madridit si pasuesi i mundshëm i Carlo Ancelottit në fund të këtij sezoni. Në mënyrë konstante emri i Zidanes është lakuar edhe për një transferim të mundshëm në Torino me Juven që e pret prej kohësh.

Allegri: Nuk do të jetë e lehtë në Freiburg

Juventusit shënoi fitore minimale ndaj Freiburgut (1-0) në ndeshjen e parë të 1/16 së finale në Ligën e Evropës. Trajneri i "Zonjës së Vjetër", Massimiliano Allegri, ka thënë se është i kënaqur me fitoren, por e ka pranuar se nuk do të jetë aspak lehtë në ndeshjen kthyesë në Gjermani. "Luajtëm një lojë të mirë, me intensitet të madh dhe teknikë të mirë. Rrezikuar të na barazonin, por për fatin tonë të mirë goli u anulua, por ne bëmë shumë pasime të gabuara gjatë ndeshjes. Duhet të përmirësohemi, sepse koha është thelbësore, përndryshe të tjerët do të kthehen. Nuk do të jetë e lehtë në Freiburg, por ajo që më bën të mendoj pozitivisht është se ne kemi krijuar shumë dhe ata do të na japin hapësirë atje. Duhet t'i shfrytëzojmë të gjitha mundësitë", ka thënë Allegri.

Real planifikon transferimin e Bellinghamit dhe Haalandit

Real Madridi po mendon të realizojë dy transferime të fuqishme në afatin kalimtar të verës. Fjala është për sulmuesin e Manchester Cityt, Erling Haaland, si pjesë e një plani për të sjellë një brez të ri yesh të rinj, duke përfshirë edhe Jude Bellingham e Borussia Dortmundit. Spanjollët e shohin Haalandin si i duhuri për ta zëvendësuar Benzemanë. 22-vjeçari ka shënuar 27 gola në 25 ndeshje për Cityn dhe është i lumtur në "Etihad". Por, pavarësisht kësaj, sipas "The Independent", "Los Blancos" po mendon ta tentojë nënshkrimin e tij këtë merkato verore dhe të "rëmbente" pas vetëm një sezoni norvegjezin nga skuadra e Pep Guardiols.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

